



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Testimi dhe Vlerësimi për Gjuhën B (1)

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 30 leksione / 10 seminare

Viti / Semestri : Viti 1, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master Mësuesi

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Ky kurs ofron një studim që studenti të zotërojë aftësinë për të përzgjedhur instrumentet e matjes dhe të vlerësimit. Të përgatisë një vlerësim motivues me kritere dhe objektiva të përcaktuar qartë si dhe mundësisht me parametra matës. Të zotërojë aftësinë për të hartuar vetë teste bashkëkohore, në përputhje me objektivat dhe nivelin gjuhësor. Të zotërojë aftësinë për të administruar dhe analizuar testet. Të interpretojë vlerësimet e nxënësve. Të regjistrojë rezultatet e nxënësve. Të kryejë raportimin e vlerësimeve.

Objektivat specifikë lëndorë:

1. Zhvillimi i kompetencës për të arsyetuar, argumentuar dhe sistemuar njohuritë si nëpërmjet përzgjedhjes së materialeve ashtu edhe nëpërmjet diskutimeve dhe paraqitjes së punimeve dhe projekteve përgjatë kursit.
2. Zhvillimi i kompetencës për të menduar në mënyrë analitike, kritike dhe logjike me qëllim interpretimin e materialeve të ndryshme dhe vlerësimin e njohurive të nxënësve në gjuhën e huaj.
3. Zhvillimi i kompetencës për të vlerësuar në mënyrë profesionale.
4. Zhvillimi i kompetencës hartuar teste bashkëkohore, në përputhje me objektivat dhe nivelin gjuhësor.

Rezultate të pritshme:

Kursi synon aftësimin e studentëve në përvetësimin e metodologjisë së vlerësimit, në mënyrë që këta të fundit ta shohin atë si motivues dhe jo si ndëshkues, që vlerësimi të jetë i besueshëm dhe transparent, me kritere dhe objektiva të përcaktuara